



Ekspertët fiskal në Mazars, sjellin pranë jush buletin informativ të rradhës si një përmbledhje e lajmërimeve zyrtare të publikuara në vendin tonë gjatë muajit të fundit.

## ❖ Ndryshime në ligjin “Për tatimin mbi te ardhurat”

Duke filluar nga data 1 Korrik 2022 mënyra e përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat ndryshon si më poshtë:

E ardhura nga paga (Lekë/muaj)		E ardhura e tatueshme (Lekë/muaj)		Norma tatimore (%)
Nga:	deri në (duke përfshirë):	Nga:	deri në (duke përfshirë):	
0	40,000	0	40,000	0%
40,001	50,000	0	30,000	0%
		30,001	50,000	50% * 13% të shumës mbi 30,000 Lekë
50,001	Më tepër	0	30,000	0%
		30,001	200,000	13% të shumës mbi 30,000 Lekë
		200,001	Më tepër	22,100 lekë + 23% të shumës mbi 200,000 Lekë

*Burimi: Fletore zyrtare nr.195, datë 17.12.2021, Ligji 113/2021 datë 25.11.2021 për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.*

Efekti që pritet nga ky ligj është lehtësimi i barrës tatimore për shtresën në nevojë të cilët realizojnë të ardhura nga punësimi në nivelet nga 30,000 deri në 50,000 Lekë, si dhe e shtresës së mesme me nivel të ardhurash nga punësimi nga 150,000 deri në 200,000 Lekë.

## ❖ **Ndryshime në udhëzimin për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme**

Janë miratuar ndryshimet e mëposhtme në lidhje me udhëzimin për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme:

1. Ndryshon përcaktimi për entitetet te cilat nuk janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme. Kështu, nuk janë subjekte “të tatimit mbi të ardhurat personale” nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme:
  - a. sipërmarrësit (ndërtuesit) në fushën e ndërtimit, të pajisur me NIPT, pavarësisht nga statusi (“person fizik” apo “person fizik tregtar”), të cilët ndërtojnë për qëllim shitjeje;
  - b. investitorët në fushën e ndërtimit, të cilët financojnë produktin e ndërtimit me qëllim shitjeje, në rastet kur janë të regjistruar në Qendren Kombwtare të Regjistrimit (janë të pajisur me NIPT) dhe u është caktuar përgjegjësia tatimore.Subjektet e mësipërme janë pagues të “taksës” vendore mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, sipas parashikimeve në nenin 28, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
2. Do të përfshihen në kategorinë e subjekteve që përveç taksës vendore mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, do të duhet të paguajnë edhe tatimin mbi të ardhurat personale nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, subjektet që gjenden në kushtet e mëposhtme:
  - a. investitorët në fushën e ndërtimit, të cilët financojnë produktin e ndërtimit, me qëllim shitjeje në rastet kur nuk janë të regjistruar në organin tatimor (nuk janë të pajisur me NIPT) dhe nuk u është caktuar përgjegjësia tatimore;
  - b. personat fizikë tregtarë, në rastet kur e kanë marrë këtë status dhe janë pajisur me NIPT në momentin që kanë nisur shitjen e produktit të ndërtimit. Personat, që lejen e ndërtimit dhe regjistrimin e pasurive e përfitojnë në emrin e tyre si individë, nëse në momentin që fillojnë shitjen e produktit të ndërtimit, pajisen me NIPT, “person fizik”, duhet të paguajnë edhe tatimin mbi të ardhurat personale nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme ose tatimin mbi fitimin nga veprimtaria tregtare;
  - c. individët, të cilët lejen e ndërtimit, të shfrytëzimit/përdorimit dhe regjistrimin e ndërtimeve e kanë në emrin e tyre si individë, por në momentin kur fillojnë shitjen, pajisen me NIPT “Person fizik” dhe më pas e mbyllin dhe vazhdojnë shitjet po si individë. Këta individë duhet të paguajnë edhe tatimin mbi të ardhurat personale nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme ose tatimin mbi fitimin nga veprimtaria tregtare.”

# Buletin informativ

3. Ndryshon përcaktimi i vlerës së blerjes për shitjen e ndërtesave të përfituar nga shkëmbimi i truallit.
  - a. Në rast se trualli i këmbyer ka qenë i rivlerësuar sipas akteve të rivlerësimi të regjistruara në ZVRPP, si vlerë në blerje (vlerë e zbritshme) do të merret vlera e truallit, sipas këtyre akteve të regjistruara në ZVRPP.
  - b. Në rastet kur për truallin e këmbyer nuk ekziston një kontratë shitjeje apo akt rivlerësimi, si vlerë e truallit për metër katror të dhënë në këmbim të përfitimit të sipërfaqes së banimit/tregtisë/shërbimit do të konsiderohet vlera, sipas çmimeve për m<sup>2</sup> sipërfaqe trualli të dhëna në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, apo të akteve vijuese nënligjore, që miratojnë çmimet referuese mbi tokën për metër katror.
4. Do të jëtë objekt i tatimit sipas udhëzimit të përmendur, pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi, vetëm në rastet kur plotësohen njëkohësisht këto dy kushte:
  - a. nga ndarja në natyrë e pasurisë krijohet pabarazi e pjesëve, sipas kuptimit të nenit 207 të Kodit Civil; dhe
  - b. vlera e kompensimit të pjesëve ideale pas pjesëtimit, për bashkëpronarët që nuk marrin pjesë në natyrë nga pasuria, është më e madhe se vlera e këtyre pjesëve ideale në kohën e krijimit të bashkëpronësisë.
5. Do të merret parasysh nga ASHK-ja vetëm një herë (për një transaksion të realizuar), vlera e shitjes së pasurisë së paluajtshme për efekt të tatimit e cila do të përcaktohet nga persona të licencuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, në rastet e shitjes së ndërtesave me koeficient amortizimi mbi 50%.

**Burimi:** Fletore zyrtare nr.192, datë 14.12.2021, Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 15/1, datë 25.11.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”.

## ❖ Zgjatet afati i rivlerësimi të pasurive të paluajtshme për individët

Në bazë të aktit normativ nr. 35 datë 24.12.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, të ndryshuar zgjatet afati i rivlerësimi të pasurive të paluajtshme nga individët. Afati i ri është vendosur data 30 Prill 2022.

**Burimi:** Fletore zyrtare nr.202, datë 28.12.2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, të ndryshuar.

## ❖ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndryshon nga furnizim i përjashtuar në furnizim me shkallë të reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar në normë 10%, furnizimi i inpleteve bujqësore, ku përfshihen plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, me

# Buletin informativ

përrjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombënuar të Mallrave, Lista e kategorive të inpuve bujqësore, sipas këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Ndryshon vlera minimale e kontratave të investimeve për të cilat importet e makinerive dhe pajisjeve përrjashtohen nga pagesa e TVSH-së nga 50 milionë në 500 milionë.

Ndryshon norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë nga 6% në 0%.

**Burimi:** Fletore zyrtare nr.197, datë 21.12.2021, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

## ❖ Shtesë në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Përrjashtimisht parashikimeve në këtë ligj, zbatimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative që lidhen me zbatimin efektiv të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, do të fillojë të aplikohet pas datës 30.6.2022, për tatimpaguesit, si më poshtë:

- Tatimpaguesit e regjistruar me përrgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, të cilët kryejnë vetëm shitje me para në dorë kundrejt konsumatorëve finalë, persona të patatueshëm;
- Tatimpaguesit që ofrojnë furnizimin me ujë për konsumatorët finalë, si dhe tregu i rregulluar i energjisë elektrike;
- Bankat apo institucionet financiare për njoftimin e pagesave të e-Faturave të lëshuara nga subjektet tatimpagues”.

**Burimi:** Fletore zyrtare nr.202, datë 28.12.2021, Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

## ❖ Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar

Në ne nenet 4, 5 dhe 6 te ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, janë bërë disa shtesa si më poshtë:

Shtesat ne taksat kombetare	Niveli I takses	Agjentet e mbledhjes së taksave
Taksë për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur	100 Lekë/KG	për taksën e vendosur për importin/prodhimin janë organet doganore/tatimore
Taksë për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara	16 Lekë/Litër	për taksën e vendosur për importin/prodhimin janë organet doganore/tatimore

# Buletin informativ

Taksë për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit	150 Lekë/Litër	për taksën e vendosur për importin/prodhimin janë organet doganore/tatimore
Taksë për importimin dhe prodhimin e krem qumështit	150 Lekë/Litër	për taksën e vendosur për importin/prodhimin janë organet doganore/tatimore
Taksë për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare	40 Lekë/Litër	organet doganore

Përfshihen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi, fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat në etiketën e miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kanë të evidentuar sasinë në përqindje të këtyre produkteve që janë trupëzuar në produktin përfundimtar.

**Burimi:** Fletore zyrtare nr.197, datë 21.12.2021, Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar

## ❖ Ndryshon lista e mallrave të tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë

Në bazë të ligjit 114/2021 datë 25.11.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në republikën e shqipërisë", të ndryshuar, kanë ndodhur disa ndryshime në listën e mallrave të tatueshme me akcizë. Lista e rifreskuar mund të gjendet në linkun e mëposhtëm :

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20211126150946Ligj%20nr%20114%20dhe%20shtojca.pdf>

**Burimi:** Fletore zyrtare nr.195, datë 15.12.2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në republikën e shqipërisë", të ndryshuar

## KONTAKT

### MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje mbi çështjet e mësipërme ose për çështje të tjera në fushën fiskale, ju lutem kontaktoni:

#### Teit GJINI

Managing Partner  
teit.gjini@mazars.al

#### Daniela XHAKO

Head of Accounting and Tax Compliance Services  
daniela.xhako@mazars.al

#### Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889  
E-mail: info@mazars.al